



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 305 Akti

Nr. 289 Vendimi
Tiranë, më 6.8.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|----------------------------|-----------|
| Etleda Çiftja | Kryesuese |
| Valbona Sanxhaktari | Relatore |
| Xhensila Pine | Anëtare |

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në datën 3.8.2020, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Lindita Hoxha**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimet e relatores së çështjes, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Lindita Hoxha është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

2. Znj. Lindita Hoxha bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.3.2019, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari (relatore). Trupi gjykues ka zgjedhur me mirëkuptim kryesuesen Etleda Çiftja, e ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit nga anëtarët.

3. Subjekti i rivlerësimit znj. Lindita Hoxha është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit, dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

4. Në vijim janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

5. Në datën 17.7.2020, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit dhe dokumentacion ligjor provues.

7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin, znj. Lindita Hoxha, në seancën dëgjimore, të datës 3.8.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 3.8.2020, në prani të subjektit të rivlerësimit e vëzhgueses ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht e kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vijuar në seancën e shpalljes së vendimit në datën 6.8.2020.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha (S.), ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

11. Subjekti i deklarimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

12. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;*
- *ka mosdeklarim të të ardhurave të bashkëshortit dhe likuiditeteve në bankë;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

13. Referuar kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi.

14. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në

përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku ka rezultuar, si vijon:

Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *Vetting*, ka deklaruar:

15. Apartament banimi me sip. 92 m², ndodhur në Rr. “****”, lagjja “****”, Shkodër, në bashkëpronësi bashkëshortore. Ky apartament është blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 2,000,000 (dy milionë) lekë.

16. Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: para të marra hua, shlyerja e së cilës është bërë me kredi; *overdraft* – tri paga mujore; kursimet e subjektit dhe të bashkëshortit, të siguruara nga puna ndër vite.

17. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, e blerë në datën 9.8.2006, me vlerë 200,000 (dyqind mijë) lekë dhe pjesë takuese 50 %. Në këtë vit deklarohet si burim krijimi për këtë pasuri: detyrime financiare si hua-*cash* në persona privatë, në shumën 1,000,000 (një milion) lekë; si dhe *overdraft* në shumën 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë i marrë më 20.8.2006.

18. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, në të dhëna konfidenciale, subjekti shprehet se huadhënësit janë nga persona të afërm të familjes dhe nga të njohurit.

19. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti deklaroi se huatë e deklaruara më parë e shlyer tërësisht.

20. ASHK-ja Shkodër konfirmon në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit është regjistruar pasuria apartament me sip. 92 m², në lagjen “****”, Shkodër.

21. Në lidhje me çmimin e blerjes dhe koston e investimit në këtë apartament

21.1 Komisioni hetoi lidhur me çmimi e blerjes së apartamentit në kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.7.2006, krahasuar me çmimin e referencës sipas udhëzimit nr. 5, datë 23.11.2005, ku përcaktohet se kostoja e shitjes në lekë/m², për qytetin e Shkodrës do të jetë në vlerën prej 45,819 lekë/m², vlera e apartamentit me sip. 92 m², sipas EKB-së, në kohën kur është blerë apartamenti, ka qenë në vlerën 4,215,348 lekë.

21.2 Nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Shkodër, është kërkuar informacion mbi çmimin e referencës së shitblerjes në vitin 2006 për pasuritë apartament në Shkodër dhe përcjelljen e dokumentacionit apo kontratave përkatëse të shitblerjes, të ngjashme me pronën nr. ***, në z. k. ***.

21.3 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se në momentin e blerjes së apartamentit, nuk ka qenë në dijeni se sa ka qenë kostoja e ndërtimit dhe e shitjes së apartamenteve të ndërtuara para viteve 1990.

21.4 Në vijim, në lidhje me çmimin e blerjes së banesës subjekti sqaron se kontrata e shitjes është një veprim juridik, që lidhet me marrëveshjen e dy palëve dhe duhet pasur parasysh që sendi i shitur është apartament banimi, ku sipërfaqja reale e përdorimit të tij është rreth 70 m² dhe se banesa ka qenë në gjendje jo të përshtatshme për të banuar, pasi ka qenë e amortizuar.

21.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e sa më poshtë vijon:

- duket se çmimi i blerjes së apartamentit është më i ulët se çmimi i referencës së zonës;
- duket se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor provues investimin për rikonstrukcion të bërë në apartament.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

21.6 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Për sa i përket çmimit të blerjes, theksoj se apartamenti që unë kam blerë nuk është i vetmi që është shitur apo blerë me këtë çmim në këtë zonë, konkretisht tek apartamenti im rezultojnë edhe dy kontrata të tjera shitblerjeje, përkatësisht kontratat nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.10.2006 dhe kontratat nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2002, të cilat bëjnë fjalë për apartamentin me të njëjtën sipërfaqe prej 92 m².”*

22. Në lidhje me burimin e krijimit hua marrë cash nga shtetasi S. B.

22.1 Në formularin e deklarimit të pasurisë *Vetting*, vetem bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi hua të marrë *cash* nga shtetasi S. B., në shumën 1,000,000 (një milion) lekë në vitin 2006 për blerje apartamenti.

22.2 Ndërkohë që subjekti në formularin e deklarimit të pasurisë *Vetting* deklaroi se ka shlyer borxhin e marrë, nëpërmjet kredisë bankare në Raiffeisen Bank ndërsa në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar shlyer borxhi deklaruar më parë.

22.3 Në formularin e deklarimit të pasurisë në vitin 2006 subjekti ka deklaruar detyrime hua *cash* në shumën prej 1,000,000 (një milion) lekësh, **në persona privatë, dhe në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ku kërkohet identiteti i personit fizik apo juridik huadhënës ka referuar se huadhënës janë persona të afërm të familjes dhe nga të njohurit.**

22.4 Nga korrespondenca e mbajtur me bankat e nivelit të dytë rezultoi se në datën 12.12.2007 subjekti të rivlerësimit dhe bashkëshortit i është aprovuar kredi 1,000,000 (një milion) lekë.

22.5 Subjekti, në lidhje me marrjen e kredisë, në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar se ajo ka shërbyer për shlyerjen e borxhit dhe rregullim shtëpie.

22.6 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa vijon:

- Vihet re një mospërputhje midis deklaratës *Vetting* me deklarimet e subjektit në DPV-të përkatëse për huan e marrë z. S. B., pasi subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 huan e marrë nga ky shtetas, por ka deklaruar vetëm hua *cash* marrë personave të afërm dhe të njohurve, pa përmendur gjeneralitetet e tyre dhe në DPV-në e vitit 2007 deklaroi shlyerje të huave të mëparshëm, pa përmendur përsëri se kujt ia shlyen huan.
- Personi tjetër i lidhur, z. S. B., nuk provon me dokumentacion ligjor provues mundësinë financiare të krijimit të vlerës prej 1,000,000 (një milion) lekësh.

23. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Nga ana ime është deklaruar si borxh i marrë në cash nga persona të afërm të familjes dhe të njohur, por nuk është evidentuar emri i huadhënësit, pa ndonjë qëllim, kjo mbase edhe për shkak të mungesës së përvojës në plotësimin e deklaratës së pasurisë, pasi kanë qenë vitet e para që ne plotësonin deklaratat vjetore të pasurisë.*

24. Në lidhje me burimin *overdraft* në shumën 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë

24.1 Subjekti ka deklaruar se për blerjen e apartamentit ka përdorur si burim edhe të ardhura nga *overdrafti* në Raiffeisen Bank.

24.2 Nga hetimi i kryer rezultoi se në deklarimin periodik të vitit 2006 subjekti ka deklaruar marrjen e *overdraft*-it në datën 20.8.2006, pas lidhjes së kontratës.

24.3 Rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi të përdorë të ardhura nga *overdrafti* deri në datën e lidhjes së kontratës më 10.8.2006.

24.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa deklarimi i subjektit të rivlerësimit për përdorimin e *overdraft*-it si burim nuk përputhet me informacionin e mbledhur gjatë hetimit administrativ.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

24.5 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: “...*dua të theksoj edhe një herë se unë e kam përdorur overdraft-in në masën e tre pagave mujore (270.000 lekë) për të blerë këtë apartament, duke pasur kursime në cash deri më datë 31.7.2006, në shumën rreth 750.000 lekë, së bashku me 270.000 overdraft, si dhe 1.000.000 lekë borxh shtetasit S. B., borxh ky i cili është shlyer në vitin 2007 me anë të kredisë së marrë pranë ‘Raiffeisen Bank’.*”

25. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë kursime të siguruara nga puna ndër vite

25.1 Referuar pyetësorit të datës 8.1.2020 subjekti ka shpjeguar se shuma e kursimeve, të cilat ka pasur gjendje në kohën e blerjes së apartamentit në datën 31.7.2006, ka qenë 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

25.2 Në deklaratën periodike para fillimit të detyrës në vitin 2003 nuk deklarohen gjendje *cash*.

25.3 Në DPV-në e vitit 2004 deklarohet “shtuar 500,000 (pesëqind mijë) lekë kursime”.

25.4 Në DPV-në vitit 2005 deklarohet “shtuar 700,000 (shtatëqind mijë) lekë kursime”.

25.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime, për sa nuk është deklaruar pakësimi i gjendjes *cash* në vitin e blerjes së kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

25.6 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: “*Në lidhje me konkluzionin se nuk është deklaruar pakësimi i gjendjes cash në vitin e blerjes së kësaj pasurie, sqaroj se duke qenë se kam deklaruar blerjen e apartamentit dhe burimet e kësaj blerjeje, nuk e kam vlerësuar (mbase pakujdesi) se duhet të deklarohet pakësimi i gjendjes cash.*”

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, arsyeton se:

26. Në lidhje me çmimin e blerjes dhe koston e investimit në këtë apartament

26.1 Lidhur me çmimin e apartamentit dhe koston e rikonstruksionit të tij, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke provuar me dokumentacion provues kontrata të ngjashme në të njëjtin vit dhe zonë, si dhe duke shpjeguar bindshëm edhe koston e investimit për të përmirësuar gjendjen e këtij apartamenti.

27. Në lidhje me huan si burim krijimi dhe mundësinë financiare të huadhënësit

27.1 Në lidhje me burimin e krijimit hua subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet midis deklarimeve të kryera ndër vite në lidhje me huadhënësin.

27.1.1 Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë se në deklaratën e vitit 2006 nuk është deklaruar se kjo hua është marrë nga shtetasi S. B., por referohet si huamarrje në persona të afërm dhe familjarë, dhe në deklarinin e vitit 2007 deklarohet shlyerja e huave pa përcaktuar shtetasin S. B.

27.1.2 Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është një proces vlerësimi strikt financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27.2 Detyrimi ligjor i subjektit, për të deklaruar pasuritë dhe detyrimet, ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin në deklaratat periodike vjetore të çdo pasurie, përfshirë edhe detyrimet monetare ndër vite. **Sipas këtij ligji në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ku kërkohet identiteti i personit fizik apo juridik huadhënës subjekti ka referuar se huadhënës janë persona të afërm të familjes dhe nga të njohurit.**

27.3 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të viteve 2006 - 2007, të subjektit vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile.

27.4 Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, duke e krahasuar ato me deklarimet në deklaratat periodike, si dhe në deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ.

27.6 Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarim në deklaratën *Vetting* krahasuar me DPV-të e këtyre viteve në lidhje me huan. Ky ndryshim konsiderohet nga trupi gjykues si përpjekje për të përmbushur detyrimin ligjor të justifikimit të burimit të ligjshëm të huas, shërbyer për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme.

27.7 Nga analiza e rrethanave faktike si më sipër është pamundur të arrihet në një konkluzion të qartë dhe bindës se cilat janë deklarimet e subjektit të rivlerësimit që përputhen me situatën e vërtetë faktike lidhur me huane dhe huadhenesit si burim krijimi i kësaj pasurie.

28. Në lidhje me burimin *overdraft* në shumën 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë

28.1 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit në vitin 2006, vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile.

28.2 Duke iu referuar deklarimeve të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, apartamenti është blerë në datën **9.8.2006** dhe *overdraft* në shumën 270,000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë është marrë më **20.8.2006**.

28.3 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga *overdrafti*, trupi gjykues, bazuar në deklarimin e vetë subjektit në vitin 2006, arrin në përfundimin se ky *overdraft* nuk është përdorur si burim krijimi për këtë pasuri.

28.4 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë kursime, të siguruara nga puna ndër vite

28.4.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 pakësimin e gjendjes *cash* për krijimin e pasurisë apartament, si dhe nuk ka deklaruar të ardhurat si burim krijimi.

28.4.2 Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në formën e gjendjes *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

28.4.3 Trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 9043/2003, i ndryshuar, ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë dhe pakësim të pasurisë në çdo formë që ndodh përgjatë një viti periodik.

28.4.4 Trupi gjykues, bazuar në analizën ligjore të mësipërme vlerëson se përdorimi i kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar duhet të merret sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

28.4.5 Trupi gjykues i dha vlerën e provës DPV-së së vitit 2006 të subjektit, në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile.

28.4.6 Në analizë të DPV-së së vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* për krijimin e pasurisë apartament, por ka deklaruar se pasuritë e tjera të luajtshme dhe të paluajtshme kanë mbetur si në deklarin e mëparshëm.

28.4.7 Në konkluzion, trupi gjykues, lidhur me apartament banimi me sip. 92 m², ndodhur në lagjen “****”, Shkodër, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare në krijimin e saj, sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk provohet që kursimet e overdraftit janë përdorur për këtë pasuri dhe subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarin në deklaratën *Vetting* në lidhje me huan, për të përmbushur detyrimin ligjor të justifikimit të burimit të ligjshëm të saj.

29. Apartament me sip. 54 m², me nr. pasurie ****, në pronësi të bashkëshortit të subjektit, blerë në vitin 2001 me kontratë shitjeje nr. ****, datë 6.6.2001, në vlerën 500,000 lekë.

30. Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: kursimet e bashkëshortit të subjektit, z. G. J., të siguruar nga puna, ndër vite, para vitit 2001.

31. ASHK-ja Shkodër ka identifikuar pronën me sip. 54 m² në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. G. A., fituar sipas aktit të shitblerjes nr. ****, datë 6.6.2001.

32. Subjekti, për këtë apartament, ka deklaruar në pyetësin standard se ka jetuar në këtë apartament pasi është martuar me bashkëshortin në datën 18.12.2003. Më tej, në vitin 2006 këtë apartament i është bashkëngjitur pasuria apartament me sip. 92 m², sipërtrajtuar.

33. Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit, z. G. J., deklaroi se kjo pronë është blerë në vlerën 500,000 (pesëqind mijë) lekë, në pronësi vetëm të tij dhe si burim i krijimit të kësaj pasurie janë kursimet e tij të siguruar nga puna ndër vite, para vitit 2001.

33.1 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit, të ardhura të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2001.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

33.2 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Familja e bashkëshortit ka edhe tokë tjetër në pronësi të fituar në bazë të ligjit nr. 7501, ‘Për tokën’, (ullishte), me sip. 19.500 m², me nr. pasurie ****, vol. ****, f. ****, z. k. ****, fshati ****, vërtetuar kjo me AMTP-në nr. ****, regjistruar në ish-ZVRPP (ASHK) në datën 22.9.1997, nga e cila ata kanë realizuar në kohë të ardhura, duke qenë se është e mbjellë me ullinj. Bashkëlidhur foto të vërtetimit shtëpisë në pronësi të z. Xh. J.”*

Arsyetime ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

33.3 Komisioni, duke pasur parasysh shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arsyeton se:

33.3.1 Pasuria ndërtesë me sip. 120 m², ndodhur në fshatin ****, bere me dije nga foto e dërguar nga subjekti rezulton të jetë një pronë e familjes bujqësore, mbi me sip. 19.500 m², me nr. pasurie ****, fshati ****, Shkodër.

33.3.2 Mbështetur në situatën faktike më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë, pasi nga të dhënat e pasqyruara në këtë deklaratë ai deklaroi se zotëron pjesë takuese të pasurisë tokë arë, me sip. 19.500 m², me nr. pasurie ****, fshati ****, Shkodër por nuk përfshin pjesën takuese që ka mbi ndërtesën e ndërtuar mbi të.

33.3.3. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në pikën 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 1, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, në rubrikën “deklarin i pasurive” deklaroi: *“Të gjitha*

pasuritë e akumuluar, ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, ndodhura brenda dhe jashtë vendit, në pronësi, në posedim ose në përdorim."

33.3.4 Në këtë kuptim, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit, me pjesë takuese ideale të kësaj pasurie, nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të drejtat/pjesën takuese mbi pasurinë ndërtesë me sip. 120 m², ndodhur në fshatin ***.

34. **Ndërtim informal në fshatin *****, komuna ***, Shkodër, Vlera: 1,400,000 (një milion e katërqind mijë lekë. Pjesa takuese: 50 %.

34.1 Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: kursimet e siguruara nga puna ndër vite në shumën prej 580,000 (pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh; *overdraft* në shumën prej 100,000 (njëqind mijë) lekë në Raiffeisen Bank, hua në shumën prej 600,000 (gjashtëqind mijë) lekësh në vitin 2013, nga shtetasi B. R. H., sipas deklaratës datë 2.3.2015.

34.2 Sipas informacionit të marrë nga ASHK-ja rezulton se shtetasi G. Xh. A. figuron aplikues në proces legalizimi, proces i cili nuk është përmbyllur ende.

34.3 Në procesverbalin e verifikimit në terren nga Drejtoria e ALUIZN-it Shkodër rezulton data e deklaratës për legalizim me nr. *** prot., datë 19.1.2013, ndërkohë që data e kërkesës për legalizim është me nr. *** prot., datë 19.7.2013.

34.4 Subjekti, deklaron se ndërtimi informal është njëkatësh dhe është bërë me një kosto të ulët, me material të blerë në treg të lirë, pa faturë shoqëruese të mallit.

34.5 Gjithashtu, subjekti pretendon se: "*Punimet e ndërtimit janë realizuar me punën e dajës së bashkëshortit, z. F. H., i cili ka bërë punën e muratorit, si dhe shoku i bashkëshortit, i quajtur M. P., i cili nuk jeton më*".

34.6 Lidhur me koston e deklaruar nga subjekti për ndërtimin e këtij objekti në vlerën 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë, duke qenë se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë preventiv apo situacion punimesh, Komisioni iu referua çmimeve të EKB-së, për periudhën e investimit, sipas të cilave vlera e investimit do të ishte 6,638,720 lekë.

34.7 Komisioni i kërkoi subjektit foto të ndërtimit në momentin aktual. Subjekti me anë të postës elektronike dërgoi foto të këtij objekti, ku evidentohet qartë se destinacioni nuk ishte vetëm rritja e shpendëve dhe tregtimi i shpendëve në mënyrë natyrale, por gjithashtu përdorimi i këtij objekti si njësi/lokal/restorant.

34.8 Sipas shkresës nga ASHK-ja Shkodër, sipërfaqja e bazamentit të ndërtesës pa leje ishte 100 m², sipërfaqja ndërtimore totale ishte 220 m², dykatëshe dhe truall me sip. 1000 m².

34.9 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin ligjor justifikues për të vërtetuar investimin në shumën e deklaruar prej 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekësh, në objektin informal, të paraqiste dokumentacion ligjor provues për pronësinë e truallit mbi të cilin ishte ndërtuar ky ndërtim, si dhe të deklaronte sipërfaqen e ndërtimit, koston e ndërtimit dhe përdorimin aktual të objektit.

34.10 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, për sa subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues deklarimet e saj në lidhje me:

- pronësinë e truallit mbi të cilin është ndërtuar ky ndërtim;
- provimin me dokumentacion ligjor provues në lidhje me kohën e ndërtimit dhe të koston së investimit (përfshirë edhe arredimin), si dhe vlerën e investimit prej 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekësh, përdorur për këtë ndërtim.

- mosdeklarimit të subjektit se ky objekt është përdorur për njësi/lokal.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

34.11 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, shprehet se: *“Sa i përket truallit mbi të cilin është ndërtuar ky objekt, deklaroj se fillimisht bashkëshorti ka marrë informacion se kjo sipërfaqe toke është në pronësi ‘shtet’, por pas verifikimit kjo pasuri rezulton në emër të shtetasit B. A. Pra trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti për rritjen dhe tregtimin e shpendëve nuk është në pronësi tonën. Kjo marrëdhënie do të rregullohet në të ardhmen me vijimin e procedurave të legalizimit.*

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit justifikues sa i përket kohës së ndërtimit dhe vlerës së investimit, kam deklaruar se ky investim ka përfunduar në korrik të vitit 2013 dhe punimet janë kryer me punëtorë privatë të palicensuar, siç kane qenë daja i bashkëshortit i quajtur F. H., i cili e ushtron në mënyrë autodidakte profesionin e muratorit dhe që në rastin konkret ka punuar në mënyrë vullnetare, si dhe nga M. P., i cili ka punuar dhe ai në mënyrë vullnetare, pasi ka qenë shoku i fëmijërisë së bashkëshortit, siç e kam deklaruar ai nuk jeton më pasi ka gjetur vdekjen gjatë një aksidenti automobilistik.

Në këto rrethana, në mungesë të dokumentacionit ligjor që mund të jenë fatura blerjesh dhe fatura shërbimesh, situacione, preventivë, kam paraqitur aktin e vlerësimit të bërë nga eksperti i licensuar M. H. dhe foto të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të objektit. Vetë fakti që bashkëshorti ka bërë kërkesë për legalizim të objektit në datën 19.7.2013, tregon që ndërtimi informal ka qenë i përfunduar në këtë datë, kjo e provuar me dosjen e legalizimit ku është bërë aplikimi për legalizim dhe fotot e objektit të bëra në këtë kohë.

Në lidhje me konkluzionin e arritur nga Komisioni lidhur me përdorimin e këtij objekti për restorant dhe mosdeklarimin e investimit dhe fitimin e realizuar nga ky aktivitet në deklaratën vjetore dhe atë Vetting të vitit 2017, sqaroj se destinacioni kryesor ose veprimtaria kryesore e ndërtimit informal është rritja dhe shumimi i shpendëve në kushte natyrale, investimi i bërë në vitet pas 2013 e në vijim, për çdo vit nuk e ka kaluar shumën 500.000 lekë, e cila është ndryshuar më pas në 300.000 lekë, dhe as këtë vlerë, siç parashikon ligji për deklarimin e pasurive të paluajtshme dhe deklarata e pasurisë, si rrjedhojë, duke qenë në këto rrethana nuk kam vlerësuar se duhet të deklarohen.

*Në vitin 2015, kur është bërë dhe regjistrimi i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., në QKB, në këtë vit ka filluar konceptimi i ndërtimit edhe si objekt social-ekonomik, ku përveç rritjes dhe shumimit të shpendëve të bëhej dhe tregtimi i tyre në gjendje të gjallë dhe të gatuar. Ky aktivitet parashikohet specifikisht në objektin e shoqërisë ‘***’ sh.p.k., ku përfshihet edhe hapja e bareve dhe restoranteve.”*

35. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm lidhur me pronësinë mbi truallin dhe vlerën e investimit të kryer

35.1 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar Vetting; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimeve në seancën dëgjimore, arsyeton se:

35.2 Deklarimi i subjektit pas kalimit të barrës së provës se për truallin mbi të cilin është ndërtuar ky objekt, fillimisht bashkëshorti ka marrë informacion se kjo sipërfaqe toke është në pronësi “shtet”, por pas verifikimit kjo pasuri rezulton në emër të shtetasit B. A. nuk ishte në përputhje me parashikimet ligjore.

35.3 Trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti për rritjen dhe tregtimin e shpendëve rezultoi se nuk ishte në pronësi të subjektit apo bashkëshortit. Kjo marrëdhënie, e cila do të rregullohej në të ardhmen me vijimin e procedurave të legalizimit, duhet të deklarohet në deklaratën Vetting.

35.4 Për sa më sipër, edhe mosdeklarimi nga subjekti mbi pronësinë e truallit mbi të cilin ishte ndërtuar ky ndërtim rezulton i bërë në kundërshtim me udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

35.5 Në lidhje me vlerën e këtij ndërtimi, trupi gjykues vlerëson se në bazë të parashikimit të pikës 5, të nenit Ç dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për të provuar bindshëm vlerën që do të pranohet se ka pasuria ndërtim informal.

35.6 Deklarimi i subjektit se vlera e shtuar e investimit nuk ishte e detyrueshme të deklarohet në deklaratat e pasurisë sepse nuk kapte vlerën prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh, prandaj në këto rrethana nuk ka vlerësuar se duhet të deklaroheshin, nuk shpjegon se përse këto investime që i rritën vlerën objektit nuk u deklaruan në deklaratën *Vetting*.

35.7 Deklarimi i vlerës 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë nga subjekti si kosto ndërtimi pa deklaruar e përfshirë edhe koston e investimeve që i shtuan vlerën objektit ndër vite, nuk ishte në përputhje me parashikimet ligjore.

35.8 Në përmbushje të këtij detyrimi, vlerësimi i bërë nga inxhinier M. H. nuk provon vlerën e investimit të kryer gjatë ndërtimit të këtij objekti informal, pasi nuk ka përfshirë koston e investimeve që i shtuan vlerën objektit ndër vite, nuk provon me dokumentacion ligjor provues se ndërtimi është bërë me kosto të ulët apo me material të blerë në treg të lirë, për sa nuk provohet me fatura shoqëruese të mallit.

35.9 Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar se sa konkretisht është vlera e punës fizike e pretenduar, e kryer nga daja dhe shoku i bashkëshortit, pse ishte vlera e ndërtimit informal, 1,400,000 lekë dhe arsytet ku bazohej ky deklarim i kësaj vlere, në mënyrë që Komisioni të mbante në konsideratë këtë vlerë në vlerësimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

35.10 Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm vlerën që do të pranohet se ka pasuria. Ky detyrim buron nga parashikimi i pikës 5, të nenit Ç dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, por pavarësisht kësaj subjekti nuk ka paraqitur as bashkëlidhur deklaratën së pasurisë *Vetting* dhe as përgjatë hetimit administrativ, dokumentacion justifikues, që do të provonte deklaratimet për vlerën e kësaj pasurie.

35.11 Subjekti, në kushtet kur kjo pasuri është krijuar prej saj dhe bashkëshortit, në kuptim të këtyre dispozitave të përmendura më lart, kishte detyrimin të provonte vlerën e saj nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit justifikues, që do të vërtetonte pagesat e kryera ose të parashikuara se do të kryeshin për ndërtimin e saj, çdo akt shkresor që do të dokumentonte shpenzimet e kryera prej saj apo prej familjarëve për ndërtimin e kësaj banese. I vetmi akt i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim është vlerësimi i bërë nga inxhinier M. H., i hartuar prej ekspertit të kontraktuar prej saj, për nevoja të procesit të rivlerësimit.

35.12 Komisioni nuk e ka konsideruar me vlerë provuese aktekspertimin nga inxhinier M. H. përtej faktit që është hartuar, në përgjigje të kërkesave apo fakteve të paraqitura prej subjektit dhe të pacertifikuara nga ndonjë autoritet publik, por edhe sepse në brendinë e tij, akti nuk garanton se kostot e përcaktuara në të janë konkluzion i një këqyrjeje të plotë dhe analize të gjithanshme, e cila do të krijonte një panoramë të besueshme për çdo zë punimesh e vlerë respektive të kostos.

35.13 Në këto rrethana, trupi gjykues konsideron se ky aktekspertimi, i hartuar mbështetur në këto elemente, nuk mund të përdoret si referim për vlerën e kësaj pasurie.

35.14 Referimi te kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar nda EKB-ja, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi dhe sipas vlerës së këtij referimi, përafërsisht 6,000,000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar ndërtimin informal.

35.15 Edhe nëse analiza financiare do kryhej në një qëndrim tejet garantist, duke ndjekur pretendimet e subjektit, rezulton përsëri se ka mungesë të burimeve të ligjshme për ndërtimin e objektit informal për sa nuk provohet burimi i ligjshëm i huas, përdorur për këtë ndërtim, si vijon:

36. Huadhënia e z. B. H.

36.1 Hua në shumën 600,000 lekë në vitin 2013 nga shtetasi B. R. H., vërtetuar edhe nga deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2015.

36.2 Në deklaratën noteriale të huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2015, z. B. H. deklaroi se në vitin 2013 i ka dhënë hua shtetasit G. A. shumën prej 600,000 lekësh, me qëllim ndërtimin informal, të ndodhur në fshatin ***, Shkodër.

36.3 Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar se huaja e mbetur shtetasit B. H. në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë është shlyer.

36.4 Subjekti i rivlerësimit sqaron se si burim i të ardhurave të huadhënësit kanë shërbyer përfitimet nga bujqësia dhe blegtoria e tokës, të ardhurat nga puna e djalit M. H. dhe ndihma nga fëmijët e tij, dy prej tyre janë emigrantë.

36.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar kundërtën për sa nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues se z. B. H. ka pasur mundësi financiare për dhënien hua të shumës së deklaruar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

36.6 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Mendoj se kam provuar para Komisionit se shtetasi B. H. ka pasur mundësi të më japë shumën e deklaruar, pasi ai jeton në fshat, ka tokë në pronësi, ka punuar si kryeplak i fshatit *** për vite me radhë, ka djalin e vogël M. H. në marrëdhënie pune që në vitin 2007 në Bashkinë Shkodër, me të cilin jeton së bashku, ka djalin tjetër emigrant në Itali për shumë vite dhe vajzën e martuar në Belgjikë me shtetas shqiptaro-belg, nga të cilët ka përfituar të ardhura si prind i tyre, ai vetë është bujk dhe së bashku me familjen e tij nxjerrin të ardhura nga punimi i tokës dhe nga blegtoria, pasi bashkëshortja e tij merret me nxjerrjen dhe përpunimin e qumështit e të nënprodukteve të tij, çka redukton masën e shpenzimeve që do t'i duhet të bëjë një person që jeton në qytet, i cili nuk i ka këto mundësi”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

36.7 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimet e saj në seancën dëgjimore arsyeton se:

36.8 Duke marrë në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit, shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, nuk mund të konsiderohen si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.

36.9 Në nenin 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni parashikoi shprehimisht se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, kishin detyrimin të paraqisnin të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

36.10 Nisur nga rrethanat e faktit të kësaj marrëdhënie huaje, të pretenduar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, detyrimi i parashikuar nga pikat 1 dhe 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, shtrihet mbi të ardhurat e personave të tjerë të lidhur që rezultojnë si huadhënës në favor të subjektit të rivlerësimit.

36.11 Referuar deklarimeve të subjektit nuk u provua me dokumentacion ligjor provues prej saj mundësia financiare e shtetasit B. H. për të mbuluar huan me burime të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimet se lidhur me këtë pasuri :

- i. subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar investimet e kryera ndër vite dhe nuk ka deklaruar destinacionin e këtij objekti si bar-restorant, sipas parashikimeve të germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016;
- iii. subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklaramit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me truallin e saj, pasi nuk ka deklaruar dhe nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues pronësinë e truallit, mbi të cilin ishte ndërtuar ky ndërtim informal në kundërshtim me parashikimin e germës të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016;
- iv. subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë ndërtim informal në fshatin ***, komuna ***, Shkodër, në pronësi, në kuptim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

37. Në lidhje me marrëdhënien e qirasë me shoqërinë “**” sh.a**

37.1 Nga hetimi administrativ u konstatua se në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank, janë derdhur të ardhura nga qiraja nga shoqëria “****” sh.a. në vlerë totale rreth 3,000,000 lekë, të shtrira në periudhën tetor 2008 – nëntor 2014. Subjekti ka deklaruar në vetting të ardhura nga kjo marrëdhënie qeraje vetëm për vlerën 240.000 lekë.

37.2 Subjekti pyetur për këtë, deklaroi se nuk ka pasur dijeni në lidhje me këtë marrëdhënie dhe shpjegon se për periudhën 2008 – 2012, bashkëshorti i saj nuk ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie, pasi kjo llogari ka shërbyer vetëm për depozitimin e shumës së qirasë nga shoqëria “****” sh.a. dhe tërheqja e shumave është bërë në bankomate, duke ia dorëzuar në vijim pronarit Gj. P.

37.3 Në lidhje me kalimin e këtyre vlerave në llogarinë e bashkëshortit, subjekti pretendon se z. Gj. P. nuk ka pasur llogari bankare në atë periudhë.

37.4 Gjatë hetimit administrativ u mbajt korrespondenca me shoqërinë e sigurimeve “****” sh.a., e cila depozitoi kopjet e kontratave të qirasë datë 1.1.2013, dhe kontrata e qirasë datë 1.3.2014.

37.5 Shoqëria “****” sh.a. deklaroi se nuk gjenden kontratat e viteve 2008 –2009, si pasojë e ndryshimeve në pronësi të kësaj shoqërie, gjithashtu deklaroi se për vitet 2010-2012 regjistrimi është në librin e protokollit, por nuk gjendet fizikisht.

37.6 Në lidhje me të ardhurat nga shoqëria “****”, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka gjykuar dhe dhënë vendimet me nr. ***, datë 28.5.2008, nr. ***, datë 10.10.2013 dhe nr. ***, datë 24.3.2014, ku në këto tri gjykime si palë e paditur është pikërisht kjo shoqëri e sigurimeve.

37.7 Gjykata e Apelit Shkodër, në lidhje me çështjet gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, gjatë ushtrimit të detyrës, me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.a., gjatë periudhës 2008 – 2014, ka evidentuar çështjet gjyqësore, si vijojnë:

- vendimi nr. ***, datë 28.5.2008 me paditës: S. M., i paditur: “****” sh.a., Tiranë dhe Dega Shkodër, me objekt “shpërblim dëmi kontraktor në shumën 1,023,051 lekë”.

- vendimi nr. ***, datë 10.10.2013 me paditës: “****” sh. a., i paditur: A.T., me objekt “kthimin nga ana e të paditurit të shumës prej 10.008.48 euro.

- vendimi nr. ***, datë 24.3.2014 me paditës: B.M., i paditur: “****” sh.a., me objekt “dëmshtëpërblim pasuror dhe jo pasuror të shkaktuar nga vdekja e të ndjerit, S.M., si pasojë e qarkullimit të mjeteve motorike”.

37.8 Shoqëria “****” sh.a. ka konfirmuar se për periudhën 2008 – 2014 ka qenë në marrëdhënie qiramarrëse me shtetasin G. Xh. A. për ambient “zyrë”.

37.9 Subjektit iu kalua barra e provës për sa subjekti nuk i ka deklaruar të ardhurat e qirave të transferuara në llogaritë bankare të bashkëshortit nga shoqëria “****” sh.a., të cilat duhet t’i deklaronte edhe në DPV edhe në deklaratën *Vetting* dhe për sa duket se subjekti ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit, gjatë kësaj periudhe çështje me shoqërinë “****” sh.a.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

37.10 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Për periudhën 2008 – 2012, bashkëshorti nuk ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie dhe për periudhën 2008 – 2011, ka qenë i punësuar në komunën Rrethina Shkodër, e cila konfirmohet nga vërtetimet e pagave të përcjella në Komision dhe se kjo llogari ka shërbyer vetëm për depozitimin e shumës së qirasë nga ‘***’ sh.a. dhe tërheqja e shumave është bërë në bankomate, kryesisht nga agjenti i sigurimeve ‘***’ sh.a., z. I. H., duke ia dorëzuar në vijim pronarit G. P.*

*Në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni sa i përket gjykimit dhe dhënies së vendimeve me nr. ***, datë 28.5.2008, vendimit nr. ***, datë 10.10.2013 dhe vendimit nr. ***, datë 24.3.2014, ku në këto tri gjykime palë e paditur është shoqëria e sigurimeve ‘***’ sh.a., vlerësoj se në lidhje me dhënien e vendimit nr. ***/2008 ku unë kam qenë anëtare e trupit gjykues që ka dhënë vendimin, nuk kam qenë në kushtet e papajtueshmërisë me nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashikon ky nen”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

37.11 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit dhe shpjegimet në seancën dëgjimore arsyeton se:

37.12. Shpjegimi i subjektit se për periudhën 2008 – 2012, bashkëshorti i saj nuk ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie dhe për periudhën 2008 – 2011, dhe se kjo llogari ka shërbyer vetëm për depozitimin e shumës së qirasë nga “****” sh.a. dhe tërheqja e shumave është bërë në bankomate, duke ia dorëzuar në vijim pronarit Gj. P., nuk mbështetet në asnjë fakt dhe provë dhe nuk provohet nga verifikimi i TIMS sipas te cilit Gj. P. nuk ka qene ne Shqiperi nga data 18.05.2010.

37.13 Pretendimi i subjektit se kjo vlerë i është kthyer shtetasit Gj. P., nuk provohet nga asnjë dokumentacion ligjor provues. Këto depozitime në llogarinë bankare, për periudhën 2008 – 2012, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike përkatëse dhe as në deklaratën *Vetting*, në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

37.14 Sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar “Afati dhe objekti i deklarimit”, parashikon se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj.”*

37.15 Trupi gjykues, duke pasur parasysh standardin kushtetues e ligjor që përcaktojnë dispozitat e posaçme mbi kontrollin e pasurisë, si dhe faktin se kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratat periodike të vitit 2008-2012 dhe as në deklaratën *Vetting*, si dhe nuk provohet destinacioni i tyre.

37.16 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte shumat e kaluara në llogarinë bankare të personit të lidhur gjate viteve 2008-2012, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 11, të nenit 3, neneve 30-32 dhe të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

37.17 Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, *vetting* duke mos i deklaruar keto likuiditete, në kundërshtim me parashikimet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

37.18 Përveç sa më sipër, në analizë të marrëdhënies disavjeçare me shoqërinë e sigurimeve “***” sh.a., në referim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, me ndryshimet përkatëse”, rezulton se subjekti ka shqyrtuar nr. ***, datë 10.10.2013 dhe nr. ***, datë 24.3.2014, me këtë shoqëri në një kohë kur personi i lidhur bashkëshorti i saj, ka përfituar vlera monetare në llogaritë e tij bankare në Raiffeisen Bank, nga shoqëria “***” sh. a. 3,000,000 lekë, të shtrira në periudhën tetor 2008 – nëntor 2014.

37.19 Subjekti duhet të merrte të gjitha masat e duhura për të evituar situatat e tilla të konfliktit, duke qenë e vetëdijshme se hyrja në fuqi e parashikimeve ligjore nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, e ngarkonte me përgjegjësinë e zbatimit dhe marrjen e masave për shmangien e këtyre situatave.

37.20 Trupi gjykues vlerëson se vendimet: nr. ***, datë 10.10.2013 dhe nr. ***, datë 24.3.2014 në raport me kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005, e vënë subjektin në kushtet dhe situatën e konfliktit të interesit, pasi ajo nuk duhej të merrte pjesë në vendimmarrjet, ku pala ndërgjyqëse kishte marrëdhënie juridiko-civile, gjatë gjykimit të çështjeve me bashkëshortin, nga të cilat buronin interesa të përmendura në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005.

37.21 Parimet e Bangalores parashikojnë se: *“Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa private të tij apo të një anëtari të familjes së tij, apo të kujt do tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”*.

38. Apartament banimi me sip. 64.35 m², i ndodhur në Shëngjin, Lezhë. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi kontratën e porosisë për blerje apartamenti në Shëngjin, me kursime të deklaruara çdo vit, paguar kësti i parë në shumën prej 10,000 euro, në datën 30.3.2016, në bashkëpronësi.

38.1 Çmimi i apartamentit është 35,400 euro, ku kësti i parë prej 10,000 euro është paguar më datën 30.3.2016, me nënshkrimin e kontratës dhe pjesa e mbetur prej 25,400 euro do të paguhet me tri këste, përkatësisht: (i) 8,500 euro, në datën 30.3.2017; (ii) 8,500 euro, në datën 30.3.2018; dhe (iii) 8,400 euro në datën 30.3.2019, në nr. e llogarisë së shoqërisë në Raiffeisen Bank.

38.2 Shoqëria “***” sh.p.k., informon Komisionin se subjekti ka likuiduar pagesat për apartamentin – kësti i parë në vlerën prej 10,000 euro, në momentin kur është lidhur kontrata e sipërmarrjes, është kryer pranë shoqërisë, e cila disponon mandatarkëtimin, ndërsa pagesat për këstet e tjera janë kryer me transferta bankare.

Burimet e krijimit të deklaruara në deklaratën *Vetting*

a) kësti i parë - 10,000 euro ose 1,352,700 lekë. Subjekti deklaroi në DPV-në e vitit 2015 gjendjen *cash* në shumën prej 1.200.000 lekësh;

b) kësti i dytë - 8,500 euro ose 1,130,075 lekë, paguar më 30.3.2017;

c) kësti i tretë - 8,500 euro ose 1,049,070 lekë paguar në datën 3.4.2018;

d) kësti i katërt - 8,400 euro ose 1,040,172 lekë, paguar në datën 11.4.2019.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

38.3 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit dhe shpjegimet në seancën dëgjimore arsyeton se:

38.4 Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* në deklaratimet periodike gjatë viteve kanë qenë:

- viti 2004 – kursime *cash* 500.000 lekë,
- viti 2005 – kursime *cash* 700.000 lekë;
- për 2006 - 2011 nuk deklarohet shtese apo pakesim kursime *cash*;
- viti 2012 – gjendje *cash*, 370.000 lekë;
- për 2013 – nuk deklarohet shtese apo pakesim kursime *cash*;
- viti 2014 – kursime *cash* 900.000 lekë
- viti 2015 – kursime *cash*, 1.200.000 lekë
- viti 2016 -kursime *cash*, 680.000 lekë

38.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2016 pakësimin e gjendjes *cash* për pagimin e këstit të parë të apartamentit.

38.6 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2016 vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile.

38.7 Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, në deklaratat periodike, si dhe në deklaratimet e subjektit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaratimeve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklaratimeve të sakta dhe të plota.

38.8 Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaratimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklaratimeve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

38.9 Përdorimi i gjendjes *cash*, që nuk është deklaruar si pakësim është qartësuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...]”*.

38.10 Trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa subjektin nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

39. Automjet tip “Benz 270 C Class”, blerë në vitin 2010. Vlera: 5.000 euro + 400.000 lekë pagesë për doganë. Pjesa takuese: 50 %. Kjo pasuri është fituar me kontratë shitblerjeje automjeti me nr. ***, datë 7.4.2010, me çmim 5,000 euro, me dokumente italiane.

39.1 Lidhur me burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ky automjet është blerë me kursime dhe hua të marrë shtetasve B. (në vlerën 1,000 euro) dhe R. J. (në vlerën 4,000 USD).

39.2 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë deklaruar pasurinë e luajtshme (automjet tip “Benz 270 C Class”), blerë pjesërisht të ardhurat personale në vlerën 4,000 euro dhe pjesa tjetër 1,000 euro hua.

39.3 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, ndër të tjera, për sa subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e huadhënësve/B. dhe R. J..

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

39.4 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Për sa i përket konkluzionit të nxjerrë nga Komisioni në lidhje me aftësinë e shtetasve R. dhe B. J. për të më dhënë hua në vlerat përkatëse 4,000 USD dhe 1,000 euro, mendoj se kam provuar para jush se vlera e të ardhurave vjetore të kumtit R. J. në shumën 59,000 USD është mëse e mjaftueshme që ai të ketë mundësinë që të japë hua shumën e sipërcituar. Këtu unë nuk kam paraqitur të ardhurat vjetore të tij para vitit 2010, që realisht kanë qenë të ardhura të mira, pasi ashtu siç kam deklaruar, ai është emigrant në SHBA dhe më pas në Kanada, Toronto, që nga viti 2001”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

39.5 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ arsyeton se:

39.6 Vlera e të ardhurave vjetore të shtetasit R. J., në shtetin përkatës SHBA dhe më pas në Kanada, Toronto, që nga viti 2001, nuk provon mundësinë e këtij të fundit që të japë hua shumën 4,000 USD apo të shtetasit B. J. që të japë hua shumën 1,000 euro, dhe nuk shpjegon mënyrën e marrjes së saj për sa kohe dhe nga sistemi *TIMS* rezultoi se në muajin kur është blerë makina, ky shtetas nuk ka qenë në Shqipëri.

39.6.1 Fakti i transferimit nëpërmjet sistemit bankar të të ardhurave të shtetasit R. J., nuk provon destinacionin final të këtyre të ardhurave dhe nuk shërben si burim për huan.

39.7 Trupi gjykues, lidhur me destinacionin final të këtyre të ardhurave, transferuar nga shtetasi R. J., gjatë viteve mban në konsideratë se nga hetimi administrativ rezultoi se me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2015, shtetasi R. J., ka blerë apartament në Shkodër, nga shtetasi S. B. në vlerën prej 7,790,100 lekësh.

39.8 Përveç sa më sipër, trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të justifikimit të burimit për dy huatë e marra nga vellezerit dhe nuk ka shpjeguar bindshëm mënyrën e marrjes së huave shërbyer për blerjen e pasurisë së luajtshme, automjet në vitin 2010.

39.9 Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë objekt hetimi sipas parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

40. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, zhvilloi seancën dëgjimore publike dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

40.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë

hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim në përputhje me pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

40.2 Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

40.3 Në vlerësim të rrethanave lidhur me konfliktin në dukje të interesit, ne shqyrtimin e ceshjteve me shoqerine Insig sha, trupi gjykues i çmon ato të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

41. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

42. DSIK-ja ka dërguar një raport në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita E. Hoxha. Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

43. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

44. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues i tij, si dhe mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku në përfundim ky organ ka lëshuar një raport të hollësishëm. Raporti për analizën e aftësive profesionale është bazuar në: formularin e vetëdeklaramit dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti; të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklaramit; pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Përshkrimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti

44.1 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 vendime (2 janë çështje penale themeli dhe 1 çështje civile). Sipas raportit të KLGJ-së, asnjë nga vendimet nuk është formalisht i rregullt, pasi ato nuk përmbajnë karakteristikat formale të një akti zyrtar (neni 3/2 i ligjit 84/2016).

Dokumenti nr. 1

44.2 Vendim nr. ***, datë 20.4.2015, i Gjykatës ë Apelit Shkodër, me palë të paditur P. S., i akuzuar për veprën penale “*ndërtim i paligjshëm*”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal. Me këtë vendim është rrëzuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe i padituri është dënuar me 1 (një) vit burgim. Është bërë rekurs, por Gjykata e Lartë ka vendosur “mospranim rekursi”.

44.2.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, ka qenë relatore në këtë çështje: (1) çështja është regjistruar në datën 16.9.2014 dhe ka përfunduar në datën 20.4.2015. Pra, për 7 muaj dhe 4 ditë, e cila e kalon afatin 6-mujor të parashikuar nga germa “g”, pika 5, e Aneksit të vendimit të sistemit

të rivlerësimit; (2) dispozitivi nuk është i plotë pasi i mungon parashikimi i së drejtës për ankimimin e vendimit.

Dokumenti nr. 2

44.3 Vendimi nr. ***, datë 17.4.2014, i Gjykatës ë Apelit Shkodër, me palë të paditur A. L., i akuzuar për veprën penale “*vrasje me dashje*” dhe “*mbajte pa leje e armëve*”, parashikuar nga nenet 76 dhe 278/2 të Kodit Penal. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është rrëzuar dhe të paditurit janë dënuar. Është bërë rekurs, por Gjykata e Lartë ka vendosur “*mospranim rekursi*”.

44.3.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, ka qenë anëtare në këtë çështje. Arsyetimi i vendimit është kryer prej saj pasi relatori ka qenë në pakicë. Duke qenë se subjekti nuk ka qenë relatore, afatet kohore nuk mund të llogariten në disfavor të saj.

Dokumenti nr. 3

44.4 Vendimi nr. ***, datë 3.7.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër, me paditës A. M, dhe të paditur M. M., me objekt “*zgjidhje martese...*”. Është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Është bërë rekurs, por Gjykata e Lartë ka vendosur “*mospranim rekursi*”.

44.4.1 Lidhur me këtë vendim, për sa i përket shkrimit ligjor, rezulton se janë respektuar rregullat drejtshkrimore të gjuhës zyrtare shqipe në ndërtimin e fjalëve dhe fjalive, ndonëse nuk përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Vihet re se nuk janë identifikuar problematika nga KLGJ-ja.

45. Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja nr. 1 Çështja penale nr. ***, datë 11.3.2016, e Prokurorisë së Rrethit Lezhë kundër të paditurve R. K. dhe D. SH., të akuzuar për veprën penale “*prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 20.4.2016. Gjykimi u bë në 1 seancë, e cila ishte produktive dhe ka zgjatur 1 muaj dhe 5 ditë, që është në përputhje me afatin kohor prej 6 muajsh.

Problematikat e identifikuar nga KLGJ-ja: (i) ndryshe nga dokumenti 1 më sipër, gjykata nuk e ka shqyrtuar çështjen në tërësi, por vetëm mbi shkaqet e paraqitura në ankim, edhe pse neni 425/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që, gjykata në çështje penale nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim (në gjetjet e fundit, KLGJ-ja identifikon këtë krahasim midis dokumentit 1 dhe dosjes 1, duke nënkuptuar ekzistencën e një standardi të dyfishtë nga subjekti i rivlerësimit); (ii) vendimi i arsyetuar dhe dosja gjyqësore janë depozituar në sekretari 29 ditë pas shpalljes së vendimit, afat i cili tejkalon atë 5-ditor, të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, megjithatë, një pjesë e vonësës i atribuohet aktiviteteve administrative të sekretares gjyqësore; (iii) akti i caktimit të seancës së parë gjyqësore mungon në dosje; (iv) akti i njoftimit të prokurorit për seancën gjyqësore mungon në dosje, megjithatë prokurori ka qenë i pranishëm në seancën gjyqësore; (v) edhe pse gjyqtarja, siç arsyetohet në vendim, ka administruar informacion nga çështje të tjera penale, për të cilat është dënuar i pandehuri, duket se nuk ka vendim formal për marrjen e këtyre akteve; (vi) vihet re një standard minimal i arsyetimit.

Dosja nr. 2 Çështja penale nr. ***, datë 18.2.2015, e Prokurorisë së Rrethit Shkodër kundër të pandehurit F. C., me objekt “*zëvendësimi i masës së sigurisë*”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 25.2.2015. Gjykimi zgjati një seancë dëgjimore, e cila ishte produktive dhe zgjati 7 ditë, e cila është në përputhje me afatin kohor prej 10 ditësh, të parashikuar nga neni 249/5 i Kodit të Procedurës Penale.

Problematiket e identifikuar nga KLGj-ja: (i) dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar në sekretari 12 ditë pas shpalljes së vendimit, i cili është përtej afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Një pjesë e vonësës i atribuohet veprimtarisë së sekretares; (ii) akti i caktimit të seancës së parë gjyqësore mungon në dosje; (iii) njoftimi i prokurorit për seancën mungon në dosje, sidoqoftë, prokurori ishte i pranishëm; (iv) koha e fillimit të seancës nuk ishte përfshirë në procesverbal; (v) dispozitivi është i paplotë, pasi

dispozita e së drejtës së ankimit mungon; (vi) vihet re një standard minimal i arsytimit dhe vëllim fiktiv i vendimit, pasi teksti ka përsëritje.

Dosja nr. 3 Çështja civile nr. ***, datë 2.11.2011, me paditës N. M. dhe të paditur F. K., me objekt “kthimin e sendit dhe kompensimin e dëmit”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.1.2014. Gjykimi zgjati 2 vjet, 2 muaj dhe 25 ditë, por çështja fillimisht i ishte caktuar një gjyqtari tjetër. Kur i ishte caktuar këtij subjekti rivlerësimi, zgjati vetëm 1 muaj dhe 3 ditë, që është brenda standardit të afatit kohor prej 6 muajsh.

Problematikat e identifikuara nga KLGj-ja (i) vendimi i arsyetuar dhe dosja gjyqësore i janë depozituar sekretarit 13 ditë pas shpalljes së vendimit, i cili është përtej standardit kohor 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, por megjithatë brenda afatit kohor prej 30 ditësh për të paraqitur rekurs; (ii) procesverbali i seancës dëgjimore deklaroi se të dyja palët nuk janë të pranishme dhe se janë njoftuar për seancë përmes njoftimit publik. Megjithatë, ky akt (njoftim) mungon në dosje; (iii) dispozitivi nuk është i plotë, pasi nuk parashikon të drejtën e ankimit.

Dosja nr. 4 Çështja civile nr. ***, datë 17.10.2014 me paditës Rr. V. dhe të paditur Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, me objekt “njohje e origjinalitetit të dokumentit”, mbyllur me vendimin nr. ***, datë 27.1.2016. Gjykimi u bë në 1 seancë, e cila ishte produktive dhe zgjati 1 muaj dhe 3 ditë, që është brenda standardit të afatit kohor prej 6 muajsh.

Problematikat e identifikuara nga KLGJ: (i) vendimi i arsyetuar dhe dosja gjyqësore i janë depozituar sekretarisë 1 muaj dhe 3 ditë pas shpalljes së vendimit, i cili është përtej standardit 10-ditor, të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile dhe gjithashtu përtej afatit 30-ditor në dispozicion të palëve për të paraqitur rekurs; (ii) dispozitivi nuk është i plotë, pasi nuk parashikon të drejtën e ankimit.

Dosja nr. 5 Çështja civile nr. ***, datë 24.4.2013 me paditës K. P. dhe të paditur përmbaues privat M. T., ndërhyrës kryesor N. P., me objekt “kundërshtim i veprimeve të përmbauesit”, mbyllur me vendimin nr. ***, datë 12.6.2014. Gjykimi zgjati gjithsej 1 vit, 1 muaj dhe 18 ditë, por më parë i ishte caktuar një gjyqtari tjetër. Me subjektin e rivlerësimit gjykimi zgjati 1 muaj e 17 ditë, që është brenda standardit të afatit kohor prej 6 muajsh. Subjekti i rivlerësimit kërkoi dorëheqjen nga çështja para seancës së parë, për shkak të gjykimit në raste të tjera, por dorëheqja e saj nuk u pranua nga kryesuesi i trupit gjykues. Për këtë vendim u bë rekurs dhe çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Problematikat e identifikuara nga KLGj-ja: (i) vendimi i arsyetuar dhe dosja gjyqësore i janë depozituar sekretarisë 25 ditë pas shpalljes së vendimit, i cili është përtej standardit 10-ditor, të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile, por brenda afatit 30-ditor në dispozicion të palëve për të paraqitur rekurs; (ii) dispozitivi nuk është i plotë, pasi nuk parashikon të drejtën e ankimit; (iii) nuk janë dokumentuar arsye për vonesat prej 38 dhe 28 minutash në dy seanca gjyqësore dhe arsye e padokumentuar për fillimin 9 minuta përpara orarit të një seance gjyqësore.

45.1 Informacion nga arkiva e ish-KLD-së Nga të dhënat nga regjistri i procedurës penale duket se ka pasur 2 kërkesa të ministrit të Drejtësisë (nr. *** prot., datë 30.10.2012 dhe nr. *** prot., datë 8.1.2013), që propozojnë masën disiplinore “ulje e përkohshme në detyrë 1-2 vjet në një gjykatë më të ulët”. Kjo kërkesë është shqyrtuar në mbledhjen e datës 28.5.2014, në të cilën ministri ndryshoi masën e propozuar në “vërejte me paralajmërim”. Ky propozim u hodh poshtë nga Këshilli. Ministri, më pas, propozoi masën “vërejte”, e cila u miratua (vendim nr. ***, datë 28.5.2014). Kjo masë u mor për shkak të vonesave në paraqitjen e dy dosjeve gjyqësore dhe vlerësimin e pasaktë nga gjyqtari të kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të caktimit të masave të sigurisë.

Subjekti i rivlerësimit e ankimoi vendimin e mësipërm të KLD-së në gjykatë. Gjykata e Apelit Administrative, me vendimin nr. ***, datë 24.11.2014, e rrëzoi ankimin, duke arsyetuar se masa disiplinore është proporcionale me shkeljen dhe nuk ka pasur ndonjë shkelje të procesit të rregullt

ligjor gjatë procedurës disiplinore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë kundër këtij vendimi. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë la në fuqi vendimin nr. ***, datë 24.11.2014.

Në kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, Komisioni do ta vlerësojë këtë si një masë disiplinore në fuqi, të konfirmuar edhe me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kjo masë është një nga burimet e vlerësimit të aftësive të subjektit.

Vlerësimi i përgjithshëm

Në përgjithësi, subjekti i rivlerësimit theksohet se shfaq aftësitë e saj në lidhje me njohuritë juridike dhe arsyetimin juridik në një mënyrë të diferencuar, duke sjellë si shembuj ndryshimet në zbatimin e nenit 425 të Kodit të Procedurës Penale, ndryshimet në mënyrën se si arsyeton vendimet strukturimin e vendimit, asaj që i jepet më shumë peshë në arsyetimin e secilit vendim dhe duke theksuar ndryshimin në arsyetimin midis tri dokumenteve të zgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të paktën katër dosjet e caktuara me short. Subjekti ka aplikuar zgjidhje të ndryshme për çështje të ngjashme.

DENONCIMET

46. Në Komision janë administruar denoncimet nga publiku, të cilat janë analizuar në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, si vijon: (1) denoncimi i shtetasit F. M. për vendim të padrejtë; (2) denoncimi i shtetasit L. D., i cili ka pretenduar për veprime abuzive nga gjyqtarët Lindita Hoxha dhe A. N.; (3) denoncim nga Banka Kombëtare Tregtare për vendim të padrejtë; (4) denoncim i shtetasit K. M. për vendim të padrejtë; (5) denoncim i shtetasit L. M. për vendim të padrejtë; (6) denoncim i shtetasit M. D., i cili pretendon se ka humbur gjyqin sepse nuk u ka paguar ryshfet gjyqtarëve; (7) denoncim i shtetasit M. N. për vendim të padrejtë; (8) denoncim i shtetasit Z. P., i cili pretendon për shkelje etike dhe të tjera të subjektit Lindita Hoxha dhe disa subjekteve të tjera; (9) denoncim i shtetasit T. S., i cili pretendon se gjykata ka pranuar ankimin/kallëzimin penal, pa qenë e qartë mbi arsyet pse dhe detyrat që duhen kryer (paravendosur nga prokuroria); (10) denoncim i shtetasit G. M., i cili pretendon për vendim të padrejtë.

47. Në Komision janë administruar edhe denoncime paraqitur në Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, si vijon: (1) denoncim i shtetasit A. Gj. për vendim të padrejtë; (2) denoncim i shtetasit G. M., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit është krejtësisht e paafte, hipokrite dhe e papërshtatshme për të qenë gjyqtare; (3) denoncim i një avokati privat, me të njëjtin pretendim si shtetasi G. M.; (4) denoncim i shtetasit I. D. për vendim të padrejtë; (5) denoncim i shtetasit K. P., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit i ka "shitur" shtëpinë e tij si dhe pretendon se subjekti ka marrë ryshfet.

Si konkluzion, në lidhje me denoncimet, Komisioni, pasi: mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku lidhur me denoncimet e administruara, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore; hetoi dhe analizo denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016; analizo shpjegimet e dhëna nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarës.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, "Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, ka arritur nivel minimal kualifikues.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, zhvilloi seancën dëgjimore publike, dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- a. nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.8.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA

Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore/Kundër

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Fiorela Mandro